

STAVRI PONE

NOVATORJA DHE PSEUDONOVATORJA

Problemi i përcaktimit të drejtë të raportit të traditës dhe novatorizmit është një nga çështjet themelore të letërsisë së realizmit socialist. Me këto probleme lidhet ngushtë edhe çështja e përcaktimit të një qëndrimi më të prerë ndaj rrymave apo modave të ndryshme të artit të sotëm modernist.

Arti realist është para së gjithash pasqyrim dhe shprehje e veçantë, specifike e jetës. Në procesin krijues rolin kryesor të mishërimit artistik të jetës e luan së pari njohja ideologjike, thellësia e perceptimit të saj dhe së dyti mbështetja tek tradita, në atë që shkrimtari gjen të gatshme para tij. Në simbiozën e këtyre dy akteve i pari është dominues. Mund të flasim për një art novator në qoftë se veçoria karakteristike e jetës, realiteti historiko-shoqëror i një periudhe gjen mishërimin e vet në figura, tablo, mendime dhe ndjenja përgjithësuese të papërsëritshme në konkretësinë e tyre.

Përvetësimi organik i traditës dhe shkrirja e elementeve të saj në mënyrë të re e origjinale me atë të re që sjell zhvillimi i realitetit e freskojnë vazhdimisht artin. E veçanta, origjinalja që sjell shkrimtari në veprën e tij mbi atë që ka marrë nga tradita dhe realizimi i tyre në një unitet artistik të papërsëritshëm kushtëzon novatorizmin e saj. Shkrimtarët e mëdhenj janë shquar jo vetëm nga thellësia e asimilimit të traditës, të më të qenësishmes në trashëgiminë letrare, por edhe nga origjinaliteti i lartë i veprave të tyre.

Studimi i thellë i realitetit bashkëkohor, eliminimi i së vjetëruarës nga e trashëguara për ta zëvendësuar me elemente të reja që vijnë si nevojë e brendshme e shprehjes artistike janë procese të pandërprera në zhvillimin novator të artit tonë të realizmit socialist.

Kontakti krijues i shkrimtarëve me prodhimin e së kaluarës apo me atë bashkëkohor dhe shfrytëzimi i arritjeve të tyre për pasurimin organik të veprës artistike është hallkë e domosdoshme për novatorizmin në art. Ky kontakt mund të jetë si me letërsinë e vendit ashtu edhe me atë të huaj në të gjitha planet: ideo-tematik, estetik, problemor, stilor, gjinor etj. Ndikimi i një mënyre krijuese mbi një tjetër, i një shkrimtari mbi një tjetër kushtëzohet nga afërsia e brendshme e interesave, detyrave, qëllimeve krijuese. Përvetësimi i vetëdijshëm i traditës apo i mënyrave krijuese bashkëkohëse mund të sjelli si pasojë novatorizmin në art, një kompozim origjinal, të papërsëritshëm apo në të kundërtën mund të çojë në huajtje, imitim, plagjiaturë, pra në evigonizëm.

Janë të dëmshme rastet kur huazimi shfrytëzohet për kompensim të varfërisë krijuese, kur mungon elementi i ri, origjinal i autorit dhe kështu bihet në plagjiaturë, epigonizëm, sadoqë vepra mund të pretendojë për «novitet artistik». Në vepra të tilla pseudonovatore nuk thuhet gjë posaçërisht e re; ajo në to është e njohur, e thënë më parë nga të tjerët. Fjala s'është këtu për përsëritje të një ideje apo problemi të caktuar që koha s'i ka dhënë zgjidhje. Probleme apo ide të njëjta mund të trajtohen në vepra të ndryshme. Këtu çështja është tek mënyra e krijimit, te origjinaliteti i veprës që ndonëse përsërit elemente të njohura, në tërësinë e saj ajo duhet të jetë novatore, e papërsëritshme.

Ndikime të ndryshme në procesin krijues të shkrimtarit vihen re jo vetëm te shkrimtarët bashkëkohës nga paraardhësit dhe midis vetë bashkëkohësve brenda një vendi, por edhe nga jashtë, nga letërsitë e vendeve të huaja. Në letërsinë e huaj sot dalin vepra përparimtare, që shprehin aspiratat e masave si edhe vepra reaksionare, dekadente e moderniste, të huaja ndaj idealeve të masave punonjëse. Në goftë se merret racionalja, pozitivja, e shëndosha nga tradita e huaj përparimtare dhe nëse ajo përpunohet organikisht dhe asimilohet nga tradita jonë, atëhere vepra do të rezultojë origjinale, novatore. Në të kundërtën, nëse huazohet reaksionarja apo modernistja, atëhere do të kemi pa tjetër shfaqje të imitimit, epigonizmit, estetizmit apo formalizmit.

Lufta e sotme ideologjike në fushën e mendimit estetik është ashpërsuar për shkak të rritjes së agresivitetit të përfaqësuesve të huaj të modernizmit borgjez e revizionist. Kjo luftë na detyron ne që të jemi më vigjilentë ndaj tyre për të ruajtur të pastër frymën e shëndoshë të artit tonë socialist. Tipari kryesor i modernizmit të sotëm është karakteri i tij regresiv, antipopullor e dekadent. Modernizmi si rrymë ideore dhe estetike në variantet e tij më të ndryshme (surrealizmi, ekzistencializmi, letërsia e ankthit, teatri absurd, hermetizmi etj.) dallohet nga letërsia dhe arti realist përparimtar për faktin se ai mohon forcat revolucionare të shoqërisë, transformimin progresiv të botës.

Kohët e fundit në letërsinë tonë u vunë re shfaqje të ndryshme të ndikimeve nga letërsia dhe arti i huaj modernist. Natyrisht nuk pati ndonjë rrymë të tillë të veçantë apo ndonjë modë me tipare të përcaktuara qartë, por veçse shfaqje të pjesshme, ndikime të infiltruara që, megjithatë, u ngjitën si mish i huaj në trungun e shëndoshë të letërsisë sonë. Këto fenomene u vunë re në gjini të ndryshme, si në brendi, ashtu edhe në formë. Më të dukshme ato qenë në poezi ku u vunë re «moda» të ndryshme poetike, por nuk mbetën pa u prekur dramaturgjia dhe proza sidomos në disa tregime apo në ndonjë roman.

Në mjaft poezi u vu re rendja pas një farë «mode» sipas një mënyre të veçantë të kompozimit të elementeve brendiore dhe formale jo aq si nevojë e shprehjes artistike se sa me qëllim që vepra të tingëllonte sa më e «kohës», sa më moderne. Tipar themelor dallues i këtyre krijimeve ishte largimi nga problematika sociale bashkëkohore, eliminimi i pathosit qytetar, zëvendësimi i heroit të ditës me një «un» individualist, abstrakt e shoqërisht të përcaktuar. Po-

ezitë qenë të llojeve të ndryshme nga pikëpamja e tematikës dhe e mjeteve të shprehjes e megjithatë ato nuk qenë novatore, mungonte në to pikërisht e reja që lindte çdo ditë gjatë zhvillimit të shoqërisë sonë. U botuan poezi me përmbajtje të gabuara, poezi me brendi të errët (hermetike) apo pa kurrfarë brendie, filloi të ishte në modë tema e vogël individualiste, tema nostalgjike nga e kaluara e largët (qytete antike, statuja, çvarime antike) etj., tema e mallit të trishtuar (për fëmininë, plazhet, figtë e detit, vjeshtën, dashurinë e humbur etj.), apo tema filozofike abstrakte (koha, lëvizja, njeriu, jeta, vdekja, etj.). Poezia humbiste lidhjet me realitetin, ajo u zhvillua e eci mbi një plan abstrakt, jashtë kontekstit shoqëror bashkëkohor. Në truallin e poezisë përlijte veten një pikësypim i ngushtë, i huaj ndaj përgjithësimeve të mëdha të kohës. Figura humbiste karakterin konkret dhe lidhjet me logjikën e sendeve; fitoi terren një animizim i theksuar në ndërtimin e tyre. Manifestime të tilla u vunë re kryesisht në poetë të rinj, por nuk mbetën pa u prekur edhe poetë të një brezi më të vjetër.

Në krijimet e fundit poetike sidomos të poetëve të rinj u vu re një fluks i rrëmbyer figurash që i largoheshin realitetit, që mbështeteshin nga imazhe abstrakte, jashtë konkretësisë figurative të botës. Konceptimi poetik që synohet të krijohet nëpërmjet figurave të tilla të harlisura e kapriçioze, alogjike në bazën e tyre e çorodit rrjedhën e natyrshme të asociacioneve tek lexuesi. Nga një korrelacion i tillë i shtrëmbëruar i unit poetik me realitetin humbet sensi i natyrshëm, bukuria dhe eleganca e vërtetë e metaforës.

Në mjaft poezi të viteve të fundit vihet re jo vetëm shkatërrimi i figurës artistike, tendenca e theksuar për trope abstrakte por edhe tendenca për të pohuar një ndjenjë të vogël, një koncept iluzor apo ekzistencën në vetvete. Në poezinë «Në cep të syve dhe të buzëve të tua»¹⁾ flitet për një hero lirik i cili i ka harruar edhe fjalët e gjuhës; atij s'i kujtohen as se ku vihen presjet apo pikëpyetjet. Jeta e tij është një zbrazësirë e plotë, kanë humbur lidhjet e heroit me botën, në zemrën e tij sundon shkretëtira dhe ai pyet i trembur: «Eh, si do të kalojmë dimrin sivjet?» Fjalët largohen si zogjtë në vende të tjera, fjalorët janë boshatisur si hambarët para korrjeve; duke mos ekzistuar me fjalët për të s'ka as mendime, as kujtime, gjithshka është e ftohur dhe e ngrirë. Në këto çaste heroit vë re se vetëm tri fjalë nuk kanë shtegtuar ende, tri fjalë të kaltëra «ti je e mrekullueshme», fjalë që ai i ve në cep të syve e buzëve të së dashurës. Kjo e ngroh, e vetmja urëlidhje me botën. Dhe poezia mbyllet: «Vetëm kaq. Po vallë të tjerët ç'duhen?».

U krijua kështu si të thuash një farë mode me krijimet poetike mbi dashurinë ku kjo ndjenjë shikohet si një dhëmbje, torturë ose vajtohet humbja e saj por në mënyrë abstrakte e me nota të theksuara nostalgjike. Duke ekzaltuar dashurinë-dhëmbje, duke ngritur në kult ndjenjën në vetvete pa i lënë vend pasqyrimit dhe thellimit të anës fisnike, humane të kësaj ndjenje, filloi të krijohej një shtampë poeti-

1) Xh. Spahiu, «Nëntori», 12, 1972.

ke ku dashuria çfisnikërohej, e në vend të saj sundonin tonet e një erotizmi të fortë që shkonte gati në sensualizëm. Një kuptim të tillë e gjen, p.sh. në këto vargje: «Vetëtimë. Mes errësirës unë pashë / Ovalen e buzëve / Dhe, poshtë saj / Çdo gjë që më duhej / Pastaj gjëmim. Unë ndjeva / mbi trupin tim rininë tënde. / U përkula si degë dhe gjeta / Gjithshka që më duhej²⁾».

Gjen një mori poezish erotike ku heroit trishtohet, brengoset, vështron pas xhamave të dritareve shiun që bie si lot, kërkon dashurinë tek «porta e zemrës» së vajzës, nervozohet, e quan zemrën «piramidë ku s'u fut dot kurrë», dergjet në kujtime të hidhura etj. Ja një strofë: Ti përplase me forcë portën e zemrës tënde / Dhe unë qëndrova jashtë, në shi / Pastaj dëgjova të trokitura në xhamat e dritareve / Nuk isha unë, ishte breshëri i lotëve të mi³⁾».

Në disa krijime poetike apo të prozës të kohëve të fundit u dukën qartë ndikime nga «moda» të ndryshme letrare perëndimore ku në qendër të botës vendoset «uni» i njeriut në gjendjen e tij të vetmuar, të pashpresë e në kotësinë e ekzistencës. Motivi i vetmisë, i shqetësimeve të brendshme të hermetizuara të heroit, pa lidhje në shqetësimet e mëdha, të vërteta, të kohës u duk në mjaft poezi. Lufta e brendshme shpirtërore e «unit» të heroit në këto poezi ishte fiktive, e papërligjur nga realiteti ynë shoqëror i cili nuk sugjeron motive të tilla si në poezinë me titull «Shpjegimi i fjalës vetmi»⁴⁾ ku lexojmë: «Vetmia është një orë / Pa numura dhe akrepa / Kohë e palëvizur, e ngrirë, e vdekur / Është një botë pa emra / Ku ti vetë s'ke emër / S'di pse ke lindur, ekzistencë pa qëllim / Se je jashtë njerëzve / Je jashtë çdo gjëje / Koha dhe hapësira të kanë braktisur / Dhe ti thinjesh si Robinsoni / Jo vetëm në një ishull të izolur, të largët / Por edhe brenda vetes tënde i mbyllur».

Motivin e vetmisë, e mbylljes së njeriut në vetvete duke filozofuar për lëvizjen, jetën apo duke menduar në vetmi për të dashurën e has shpesh sidomos tek poetët e rinj.

Shfaqje të ndikimeve nga modat letrare të huaja në poezinë tonë të kohëve të fundit janë jo vetëm fryma e nihilizmit, e kultit të «unit» të shkëputur nga jeta, por edhe shkëputja e formës nga përmbajtja, kultivimi i një poezie «të kulluar me brendi të papërcaktuar apo thjesht të errët, hermetike. Ndikime të poezisë hermetike u vunë re kryesisht në poetë të rinj, po ato u vunë re edhe në ndonjë poet më të vjetër.

Një varg krijimesh hermetike ishin një rebus i vërtetë për deshifrimin e të cilit duhej kohë dhe aftësi. Është e vështirë të kuptohet qartë se ç'e shqetëson poetin në vjershën: «Një këngë për Natashën»⁵⁾: «Nuk është lehtë të jetosh në një këngë / Në një altar të vdekur / perënditë mund të jetojnë më lehtë; / statujat në një varr të përbashkët, të harruar. / Më lehtë me një degë borziloku në dorë / mund të shkosh drejt lamtumirave të tua të fundit. / Nuk është lehtë të jetosh brenda një

2) A. Çapaliku, «Nëntori», 4, 1973.

3) R. Marku, «Zëri i Rinisë», 7 prill 1971.

4) M. Zeqo, «Drita», 10 shtator 1972.

5) F. Arapi, «Nëntori», 5, 1972.

kënge.. / Brenda hijes së qerpikëve të tu / rruzulli mund të fluturojë më lehtë / (Shih duart e mija, / qenkan ato fole klithme pulëbardhash), / Është vështirë të jetosh brenda një kënge, / ku mund të degjosh emrin tënd / dhe ta kuptosh — s'të thërrasin ty...» etj. Kultivimi i kësaj lloj poezie i sjell dëm serioz letërsisë pasi nën ndikimin e saj bien poetë më të rinj duke kujtuar se kjo poezi «shijohet, është e kohës, moderne». Ja dhe një poezi e tillë e një poeteshe të re: «Mbas vjeshtës së syzeve të tua / ula unë buzëqeshjen / Ndjeva puthjen e pigmenteve të ullirtë / Përmes thellësive të degëve të gjelbërta / Nën shkrepëtimat / e urëve, në kornizën e argjentë / të syve të tu, / vizione detesh / përzierje lumturish. A ua marrim dot / urëve të ullirit / shkëndijën / Për të ndezur në thellësi / shkrepëtimën?»⁶⁾ Vjersha «Vetëshërbim»⁷⁾ e përiligj hermetizimin, ajo është si të thuash një si lloj «manifesti» i kësaj mënyre të shkruari: «U bëra gështenjë / Në degët e gështenjës sime poetike / varen vjershat si kokrra / Duhet t'i gjakosish duart e mendimit / Vetë t'i këputësh / Vetë t'i qërosh / Pastaj t'i hash / Unë nuk shes gështenja të qëruara, të pjekura». Arti i vërtetë dhe i thellë nuk është i pakuptueshëm për popullin, për lexuesin e thjeshtë; t'i servirësh atij vepra në mënyrë që ai «të gjakosë duart e mendimit» për të kuptuar marifete dhe ndërlikime të qëllimta do të thotë ta fyesh atë, të pretendosh se qëndron më lart se ai.

Në një pjesë të prozës së kohëve të fundit që trajtoi kontradikta antagoniste apo temën shoqërore u vu re përfitimi i një heroit të lodhur, që synon të mbyllet në vetvete apo që do të harrojë brengat e jetës në një «liman prehje». Partizanët dhe në veçanti figura e heroit të tregimit «Fushata»⁸⁾, Dilaverit, janë vizatuar si njerëz të lodhur nga lufta, që kërkojnë mënyra për t'u shpëtuar mundimeve, «urisë dhe dëborës që ishin njëlloj të pafund». Ndaj episodeve dhe karaktereve nuk mbahet një qëndrim i shëndoshë ideor. Në këtë tregim kemi nota mërziye e apatie ndaj luftës.

Në disa tregime të tjera të kohëve të fundit u vu re një cektësi e theksuar në vizatimin e profileve të njerëzve të kohës dhe një ngushtësi në konceptimin artistik të realitetit sidomos në tregime që trajtojnë temën e dashurisë, marrëdhëniet bashkëshortore, familjare, etj. Ndikime nga moda të huaja pati kryesisht në qëndrimin objektivist të autorit ndaj personazheve apo fenomeneve. Heroi i tregimit «Pas një dielli»⁹⁾ është vizatuar si një njeri i zbrazët shpirtërisht që nuk di si ta kalojë kohën, që ka humbur lidhjet me realitetin dhe brend pas aventurash dashurie. Autori ve në gojën e personazhit shprehje të tilla si «një skepticizëm pajtonjës më bëri indiferent» dhe absurditete të tjera pa mbajtur asnjë qëndrim. Për heroin bota është një asgjë, «as shi, as diell», e errët dhe atij i vjen të thërrasë: «Hej, sillmëni Diogjenin. Diogjenin me fener. Po feneri i Diogjenit është shu-

6) S. Gjebrea, «Nëntori», 12, 1972.

7) F. Haliti, «Drita», 22 tetor 1972.

8) S. Godo, «Zëra nga burime të nxehta, Tiranë, (pa vit botimi).

9) A. Kadiu, «Studenti», 15 shkurt 1973.

ar. As shi, as diell». Mjaft drejt këto lloj marifetesh kritika i ka quajtur «akrobaci letrare»¹⁰⁾.

Është e qartë se në vepra të tilla s'ka asgjë të re e novatore; në to spikat synimi i autorëve për efekte të bujshme, për «konceptime të reja», «moderne».

Edhe në dramaturgji kohët e fundit u vu re rendja pas një farë «mode», pas kapjes së njëanshme të problemeve të rëndësishme shoqërore e morale duke lënë jashtë skenës thelbin shoqëror të këtyre problemeve, interesat dhe preokupacionet e vërteta të masave. Në disa drama u vu re mbyllja e syve para realitetit madhështor të ditëve tona, strukja e heroit në guaskën e tij brenda interesave dhe synimeve të ngushta. Heroina e dramës «Historia e një vajze»¹¹⁾ mohon dashurinë në emër të pasioneve të vrullshme dhe jeton jashtë problemeve që shqetësojnë shoqërinë tonë duke u mbyllur brenda ndjenjave të saj egoistike. Si njerëz të cekët, të ndrydhur në ndjenjat e tyre, të paaftë për t'u lidhur dhe për t'u futur në marrëdhëniet e vërteta me realitetin vizatohen edhe heronjtë e dramave «Një dimër i shkurtër», «Midis dy njerëzve», e ndonjë tjetër. Këta vërtiten brenda një cirkuidi të mbyllur të preokupuar vetëm nga problemet e dashurisë, xhelozisë, fejesës, çfejesës, probleme që janë parë e zgjidhur në mjaft raste nga pozita të liberalizmit. Edhe në konstruktimin e tyre kompozicional pati rendje drejt një farë «mode teatrale» duke i dhënë prioritet një konvencionalizimi të dukshëm në pasqyrimin e veprimit, në retrospektiva vend e pa vend, në dialogë të zvargur jashtë aksionit etj.

Borgjezia i inkurajon veprat moderniste nën pretekstin e «konsumimit të formave dhe të zëvendësimit të tyre me të reja», por pas këtyre parullave fshihet qëllimi i vërtetë që është helmosja e ndër-gjegjes së masave për t'i larguar nga lufta revolucionare si dhe komercializmi i veprave artistike. Vlerësimi i drejtë dhe kritik i krijimtarisë së huaj është i domosdoshëm në mënyrë që të dallohet në atë ajo që është përparimtare, novatore, në interes të masave nga ajo dekadente, reaksionare, pseudonovatore.

Shoku Enver thotë: «Veçanërisht njerëzit e letërsisë dhe arteve të jenë vigjilentë nga kurthet që ngre armiku i klasës si brenda ashtu edhe jashtë, të ruhen nga pilulat e helmatisura letrare dhe artistike të mbuluara nga një cipë sheqeri, të mos gënjejnë dhe entuziazmohen nga «stilet e ndritshme», nga gjoja «idetë e guximshme» dhe «figurat origjinale». Të mos harrojmë fjalën popullore «çdo gjë që ndrit nuk është ar»¹²⁾.

10) Në një artikull kritik për këtë tregim thuhet me të drejtë: «Këtij njeriu me fantazi të sëmure i fantakset herë një shpend nga malet e Amerikës së Jugut, herë do që të përfytyrojë orgjitë e përgjakshme të Neronit, herë i bëhet se do ta ndjente veten më mirë në ishullin e Manhetenit dhe here-herë që t'i sjellin Diogjenin me fener. Nga subkoshienca e tij pluskojnë lloj-lloj mërmërimesh e monologësh, përreth nuk sheh gjë tjetër veç njerëz statikë e indiferentë, një vajzë me inicialen Y dhe një lulëritëse që avitet drejt trenit si Ana Karenina... Në sytë e tij bota është një vorbull që vërtitet rreth personit të tij, ai kërkon ta dëgjojë, ta venë re se sa i ndërlikuar është në arësytimet e veta dhe pa shihni, ç'hall i madh e ka gjetur». (Vath Koreshi, *Deri ku të çon joshja për akrobaci letrare*, «Zëri i rinisë», 3 mars 1973.

11) K. Dusha, *Historia e një vajze*, dramë, vënë në skenë në Teatrin profesionist të Fierit, 1973.

12) E. Hoxha, *Raporte e fjalime*, 1967-1968, f. 490.

R é s u m é

INNOVATION ET PSEUDO-INNOVATION

La question de fixer justement le rapport entre tradition et innovation est une des questions fondamentales de la littérature du réalisme socialiste. A celle-ci est intimement rattachée aussi l'autre question qui en découle: celle de fixer une attitude plus précise envers les courants ou les modes de l'art moderniste contemporain.

L'auteur Pone, aborde tout d'abord quelques questions concernant l'innovation dans notre art du réalisme socialiste, et il met en relief les facteurs qui conditionnent la naissance du nouveau, de l'innovation, durant son développement dialectique. L'auteur fait noter que «l'assimilation organique de la tradition et la fusion de ses éléments d'une façon nouvelle et originale d'avec ce renouveau qu'apporte le développement de la réalité, raffraîchissent continuellement l'art, conditionnent son esprit novateur».

Toujours en rapport avec l'innovation dans nos lettres, Pone analyse plusieurs aspects de la pseudo-innovation, dont la ressource, comme il est dit dans la communication, réside dans la négation non-dialectique de la tradition, dans l'imitation mécanique des productions connues, en visant ainsi à agencer des «innovations» en dehors de la réalité sociale ou bien en cherchant à imiter les différentes influences de la littérature moderniste contemporaine comme contenu et forme à la fois.

Ces apparitions de pseudo-innovation ont été constatées, surtout, dans la poésie de ces derniers temps. On a remarqué chez plusieurs auteurs la tendance à suivre une certaine «mode» poétique.

La raison fondamentale de ces pseudo-innovations, souligne Pone, a été l'écart des problèmes sociaux contemporains, l'élimination du pathos urbain, en substituant au héros du jour un «moi» individualiste abstrait et socialement indéfini.

L'auteur a illustré son exposé par plusieurs exemples de ces apparitions de pseudo-innovation dans la poésie, la prose et la dramaturgie de ces derniers temps, qu'il considère néfastes, imitations puériles et éléments étrangers à notre société.

